

## Çfarë duhet të dini për ilaçet?

- » Ekipi ynë i farmacistëve do të përgjigjet në pyetjet tuaja lidhur me ilaçet, duke ju shpjeguar gjithçka për përdorimin e tyre.
- » Nëse ju doni të blini një ilaç, për të cilin nuk kërkohet recetë mjekësore, ka mundësi që në farmaci do t'ju këshillojnë të shkoni të mjeku, për hir të shëndetit tuaj. Arsyeja është që ndoshta ju vuani nga një sëmundje që kërkon ndihmë mjekësore.
- » Shumica e ilaçeve që përdoren në Gjermani prodhohen në fabrika. Vetëm në raste të jashtëzakonshme, ilaçet mund të bëhen në farmaci për nevojat e pacientëve individualë.
- » Çdo ilaçi i prodhuar industrialisht ka udhëzime të bashkangjitura me shumë informacion për përdorimin e tij. Në udhëzime mund të përmenden reagime të padëshirueshme, por kjo nuk do të thotë që ju do t'i pësoni domosdo. Ekipi i farmacistëve do t'ju ofrojë informacion të rëndësishëm dhe udhëzime për përdorimin e ilaçit.
- » Në situata të veçanta, farmacisti mund të refuzojë t'ju japë ilaçin.
- » Ka ilaçe që nuk janë halal. Ato mund të përmbajnë xhelatinë derri. Ekipi i farmacistëve do t'ju ofrojë informacion lidhur me këtë pyetje.

- » Ruani ilaçet në mënyrë që fëmijët nuk mund t'i marrin rastësisht.
- » Në kutinë e çdo ilaçi është stampuar data, deri në të cilën ai mund të përdoret. Nëse kjo datë ka skaduar, hidhni ilaçin me mbeturinat shtëpiake. Ilaçet nuk hidhen në tualet ose në lavaman. Kjo vlen edhe për ilaçet e lëngshme, siç është shurupi për kollën.

**ABDA** 

Bundesvereinigung  
Deutscher Apothekerverbände



### Kontakt

ABDA – Bundesvereinigung Deutscher Apothekerverbände e. V.  
Kommunikation und Öffentlichkeitsarbeit  
Unter den Linden 19–23 | 10117 Berlin  
[www.abda.de](http://www.abda.de)

STAND: 12/15 · ALBANISCH

INFORMACION PËR MIGRANTËT  
**Ilaçet në Gjermani**

## Ku mund të merrni ilaçe?

Refugjatët që kanë jetuar në Gjermani për 15 muaj si azilkërkuar kanë zakonisht siguracion shëndetësor. Ata mund të marrin ilaçet në farmaci. Informacioni i mëposhtëm i referohet këtij grupi të migrantëve.

Refugjatët që kanë jetuar në Gjermani për më pak se 15 muaj furnizohen me ilaçe nga institucionet kompetente.

Me përjashtime të rralla, në Gjermani ilaçet merren vetëm në farmaci dhe jo në dyqane të tjera ose në kabinetet mjekësore.



Në Gjermani ka afërsisht 20.000 farmaci. Farmacitë janë **te dallueshme përmes shkronjës së kuqe A**. Kreu i farmacisë është një farmacist apo farmacistë.

Orari i punës i farmacisë është përcaktuar në mënyrë që të mbulojnë **natën dhe ditët e pushimit**. Megjithatë, jo të gjitha farmacitë janë të hapura 24 orë në ditë. Lista e të farmacive të hapura natën dhe të dielën gjendet në faqen web **www.aponet.de**. Gjithashtu, ju mund të shkarkoni aplikacionin „Apothekenfinder“, me të cilin ju mund të gjeni farmacitë.

## Çfarë do të thotë „rezeptpflichtig“ dhe „apothekenpflichtig“?

Ka lloje të ndryshme ilaçesh.

**Ilaçet që jepen vetëm me recetën e mjekut** („rezeptpflichtig“) mund t'i merrni vetëm nëse mjeku ju ka dhënë një recetë për to. Këto ilaçe mund të kenë ngjyra të ndryshme, p.sh. bojë trëndafili.

The image shows a standard German pharmacy receipt form (Rezept). It includes fields for patient name and address, insurance details (Kassen-Nr., Versicherten-Nr., Status), and medication information (Abgabedatum, Unterschrift des Arztes). There are also checkboxes for 'geb. am' and 'Vertragstempel'.

Kur ju paraqitni një recetë në farmaci, ju do të merrni ilaçin, që mjeku ju ka dhënë. Ilaçet që jepen vetëm me recetë përfshijnë: ilaçet për tensionin e gjakut dhe diabetin, si edhe të gjithë antibiotikët për infeksione bakteriale.

Në qoftë se farmacia nuk e ka ilaçin që ju ka dhënë mjeku, ajo mund ta prokurojë zakonisht brenda disa orësh.

**Ilaçet për të cilat nuk kërkohet recetë** mund t'i blini në farmaci pa nevojë të paraqitni një recetë. Kjo do të thotë që s'ka nevojë të shkoni te mjeku paraprakisht. Ilaçet për të cilat nuk kërkohet recetë përfshijnë ilaçet për ftohje dhe shumë ilaçe kundër dhimbjes.

## Sa kushtojnë ilaçet?

**Çmimet e ilaçeve që jepen me recetë** përcaktohen nga ligji dhe, për këtë arsye, ato janë të njëjtat në çdo farmaci gjermane.

Sa duhet të paguani saktësisht për ilaçet që merren me recetë varet nga rrethanat. Në shumicën e rasteve, refugjatët marrin ilaçet falas. Në qoftë se një ilaç nuk ju jepet falas, zakonisht ju duhet të paguani vetëm një pjesë të koston. Kjo pjesë e koston quhet «pjesëmarrja». Pjesa tjetër e koston mbulohet nga siguracioni shëndetësor ose social.

Nëse ju keni të ardhura minimale, ju mund të lirohni nga detyrimi i pagimit të pjesëmarrjes. Në këtë rast ju do të merrni falas ilaçet që jepen me recetë. Kërkesa për lirimin nga detyrimi i pagimit të pjesëmarrjes mund të paraqitet në çdo siguracion shëndetësor.

Në rast të **ilaçeve që jepen pa recetë**, ju duhet të paguani çmimin e plotë. Përjashtim: Siguracioni shëndetësorë paguan edhe në rast që mjeku i ka dhënë ilaçin një fëmije nën moshën 12 vjeçare (ose një të riu me probleme zhvillimore nën moshën 18 vjeçare).